Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**



MINISTRIA E BRENDSHME  
Shërbimeve

Dokumenta Standarde te Tenderit - Procedura e Hapur e Thjeshtuar e Prokurimit të

AGJENCIA SHITETËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor  
Kurbini”**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<b>1</b>	<b>2</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	
<b>NR.</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia e pritshme</b>	<b>Cmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total</b>	<b>Afati 24 Muaj</b>
<b>1</b>	<b>Dieta nr 1</b> (Dieta normale 2700 kkl, per te rritur )	rd	634			
<b>2</b>	<b>Dieta nr 7</b> (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute) 2 000 k kal ( prot.82Kg. lip.16Kg. gluc.265 Kg.)	rd	489			
<b>3</b>	<b>Dieta nr 12</b> (Dieta diabetike) Dieta me diabetiket me diabet te ejkulibruar.(2 300 k kal (prot.88Kg. lip.92Kg. gluc.278Kg.)	rd	612			
<b>4</b>	<b>Dieta nr.13</b> (Dieta normakalorike-shume e varfer ne Na) 2 200 k kal (prot.90Kg. lip.64Kg. gluc.336Kg.)	rd	554			

AGJENCIA SHITETËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

5	<b>Dieta Nr.1B</b> normale 4-6 muaj (500kkal,prot 13.5 Kg,lyra 22.5 Kg,gluk 56.25 Kg)	rd	406			
6	<b>Dieta Nr.3 A</b> (per semundje virale,hepatite,tifo,per Kgup moshen 1-3 vjeç )	rd	279			
7	<b>Dieta Nr.3 B</b> (per femije moshen 3-14 vjeç, 1800 k.kal )	rd	349			
8	<b>Mjekun I Rojes</b> (sipas dietes nr 14 onkologjike)	rd	702			
<b>Fondi i Marrëveshjes Kuadër</b>						<b>7,019,238</b>
	<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
	<b>TVSH (%)</b>					
	<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
	<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
	<b>Nënshkrimi</b>					
	<b>Vula</b>					
	<b>Datë _____</b>					

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

## **Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

##### **Procedura e kryerjes së shërbimit.**

Pergatitja e menuse per pacientet ,personelin mjekesor ne spitale qe kryejne sherbimin e rojes mbi 12 ore pa nderprerje ,kuzhinieret dhe nd/kuzhinieret etj është percaktuar me shkresen nr 142/1 prot date 27.08.1997 “Studim mbi kategorite dietetike dhe kuoten ditore te ushqimit ne Institucionet Shendetesore Spitalore” dhe kjo menu do te kete nje shperndarje te rregullt te kalorive dhe makronutrienteve ne vaktet perkatese jo vetem brenda nje dite por edhe gjate gjithe diteve te javes.

Pergatitja dhe servirja e ushqimit eshte menduar te kryhet ne baze te flete forces ditore të sherbimeve,flete kerkeses per artikujt ushqimore te dhene nga Autoriteti kontraktor.

Oraret e shperndarjes se ushqimit sipas vakteve (mengjes, dreke, darke) do te percaktohen nga dy palet ne momentin kur nenshkruhet kontrata me operatorin ekonomik fitues.

Servirja e ushqimit duhet te kryhet e ngrohte dhe i paketuar ne vasketa prej alumini sipas vakteve dhe orareve qe do te percaktohen nga palet.

Servirja e ushqimit do te kryhet deri tek shtrati i pacientit, mjeku i sherbimit, nen mbikqyrjen e personit te autorizuar, te caktuar nga ana Spitalit.

Produketet e perdorura per pergatitjen e ushqimeve duhet te jene ne perputhje me standartet e kerkuara ne aktet normative ne fuqi. (“Ligji per Ushqimin”, ISO 9001:2015, HACCP).

Kontraktori zbaton kerkesat e ligjit 7941 date 31.05.1995 “Mbi ruajtjen e shendetit dhe te interesit te konsumatorit” per furnizimin me artikujt ushqimore ne brendesi te kuzhines si dhe per ruajtjen e higjenes te mjedisit dhe personelit.

Punonjesit ne momentin e sherbimit te ushqimit ne ambjentet e spitalit duhet te jene te pajisur me uniformen, veshjen perkatese te punes (perparese, grykese, kepuce, pantallona, kepuce), keta te fundit te jene te pajisur me libreze shendetesore të cilët do të kontrollohen ne menyre periodike dhe sa here eshte e nevojshme nga Inspektoriati i Higjenes.

Spitali do të hartojë pasqyren permbledhese bazuar ne fletet e forces ditore e dorezuar brenda ores 12.00, duke shtuar edhe numrin e personelit mjekesor dhe personelit te kuzhines.

Kete pasqyre do tia dorezojë pergjegjesit te kuzhines te Kontraktorit cdo dite, brenda ores 12.30, per ditën e neserme. Institucioni bazuar ne fletet e forces ditore, ne fillim te cdo muaji, harton pasqyren permbledhese me numrin e te semureve dhe personelit mjekesor sipas dietave per muajin paraardhes. Kjo pasqyre, pasi rakordohet, firmoset nga perfaqesuesit e te

dy paleve dhe sherben si baze per kryerjen e pageses cdo muaj nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin per Kontraktorin.

### **Kërkesat higjeno-sanitare.**

1. Operatori ekonomik duhet te siguroje një higjene te përditshme ne mbajtjen e pajisjeve te guzhines, ambienteve te gatimit, atyre te ndarjes se ushqimit .
2. Operatori ekonomik, do te paketoje dhe te evadoje çdo dite mbeturinat qe krijohen si rezultat i prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit te ushqimit.
3. Operatori ekonomik, do te respektoje rregullat e higjenës për larjen, pastrimin, dhe përpunimin e zarzavateve dhe frutave, sipas kërkesave te ligjeve ne fuqi ne fushën e higjenës dhe ushqimit.
4. Operatori për qëllime higjene dhe pastrimi te përdore detergjente dhe solucione kimike te certifikuara nga institucionet e njohura me ligj dhe te padëmshme për shëndetin e njerëzve.
5. Operatori do të përgatise racionet e ushqimit bazuar në nevojat kalorike sipas sëmundshmërisë së tij, dhe dietave të paraqitura më poshtë, si dhe të numrit të të sëmurëve të shtruar në pavione, deri tek shtrati I pacientit. Gjithashtu përgatit racionet e ushqimit të personelit mjekësor dhe personelit të kuzhinës .
6. Numri i të sëmurëve do të dali nga fletët e forcës ditore, që plotësohen sipas kartelave nga Sektori Teknik Mbeshtetes çdo ditë, brënda orës 12.00.
7. Sektori Teknik Mbeshtetes do të hartojë pasqyrën përmbledhëse bazuar në fletët e forcës ditore, duke shtuar edhe numrin e personelit mjekësor në shërbim 24 orësh. Këtë pasqyrë ia dorëzon përgjegjësit të kuzhinës të sipërmarrësit çdo ditë, brënda orës 12.30, për ditën e nesërme.
8. Sektori Teknik Mbeshtetes, bazuar në fletët e forcës ditore, në fillim të çdo muaji, do të hartojë pasqyrën përmbledhëse me numrin e të sëmurëve dhe personelit mjekësor sipas dietave për muajin paraardhës. Kjo pasqyrë, pasi rakordohet, firmoset nga përfaqësuesit e të dy palëve do të shërbejë si bazë për kryerjen e pagesës çdo muaj nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin, për Kontraktorin.
9. Sipërmarrësi përgatit ushqimin sipas menusë/dietave të miratuara, si dhe e dorëzon ushqimin deri tek shtrati i pacientit, 3 (tre) herë në ditë; në mëngjes, në drekë , në darkë
10. Për moshën pediatrike (pacientët pediatrikë), ushqimi shërbehet në 5 (pesë) vakte, përveç vakteve të sipërpërmëndura, do të ofrohet “zemra” në oraret; 10.00-10.30 si dhe në 15.00-15.30.
11. Sigurimi i makinerive , pajisjeve dhe materialeve te inventarit te imet dhe ndihmes si per guzhinen dhe pavionet eshte llogaritur te sigurohet nga kontraktori , i cil do te pergjigjet edhe per ruajtjen , mirmbajtjen dhe pastrimin e tyre.
12. Kontraktori eshte i detyruar te ruaj ne rafte te vecanta ne mjedisin e guzhines, kampionet e ushqimit te gatuar e qe shperndahet per ngrenie per te tre vaktet. Afati i ruajtjes se mostrave ( kampioneve) eshte 24-ore. Kur ka denoncime per cilesine e ushqimit, ky afat zgjat deri ne zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike. Nese rezulton se ushqimi nuk eshte ne cilesine e duhur dhe nese nga kjo vijne pasoja me ndikim ne jeten e pacienteve ndaj sipërmarrësit pervec pasojave civile (zgjidhjes se kontrates dhe penaltetit te barabarte me vleren se sigurimit te kontrates),do kete dhe pasoja penale.
13. Ushqimi para se te shperndahet detyrimisht duhet te kontrollohet nga Mjeke/infermier te Pavioneve (Urgjence, Pathologji, Pediatri, Maternitet) te Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin per sasine dhe vetite organoleptike si dhe per cilesine e gatimit.

14. Kontraktori duhet te njoftoje perpara se te shperndaje ushqimin, mjekun/ infermierin dietolog te Spitalit per kontrollin e cilesise se Ushqimit.
15. Kontraktori duhet qe ne cdo kohe te shoqeroje ushqimin e gatuar me dokumentacionin perkates.

Sherbimi i gatimit do te realizohet ne ambientin qendrore te operatori ekonomik fitues ose ne ambientet e tjera qe mundë te perdoren me qera per ofrimin e ketij sherbimi. Furnizimi me energji elektrike dhe uje kryhet ne baze te kontratave te lidhura nga operatori i kontraktuar me ndermarrjen furnizuese perkatese për ambientin e kuzhines qendrore, ne rast te marrjes me qera te ketij ambienti nga operatori fitues.

**Operatori ekonomik fitues duhet te disponoje paisjet e meposhtme:**

**Inventari i imet**

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Gota uji	Cope	50
2	Kana uji	Cope	10
3	Luge tavoline	Cope	50
4	Pirunj tavoline	Cope	50
5	Pjata te thella	Cope	50
6	Pjata te cekta	Cope	50
7	Tabaka sherbimi 50*35	Cope	50
8	Kupa me kapak	Cope	50
9	Thika tavoline	Cope	50
10	Tepsi te ndryshme(100-300)	Cope	5

AGJENCIA SHITËTËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

11	Tenxhere(5-100)	Cope	5
12	Garuzhde	Cope	5

### Inventar ekonomik

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
2	Banak sherbimi -ngrohes/ftohes/neutro	Cope	1
3	Boliere 80 lit	Cope	1
4	Tigan i madh profesional (braziere)	Cope	1
5	Dhoma frigoriferike 2*2	Cope	1
6	Frigorifere freskues/ ngrires	Cope	1
7	Frulatore industriale	Cope	1
9	Makine gires mishi industriale	Cope	1
10	Makine kombinat zarzavatesh industriale	Cope	1
11	Karrela sherbimi me tre kate	Cope	1
12	Karroca termike sherbimi ushqimi (banjomari)	Cope	1
13	Karroca sherbimi per mbledhje tabaka sherbimi	Cope	1
14	Lavamane inox dopie 200*70	Cope	1
17	Peshore te vogla	Cope	1



18	Shtrydhese frutash industriale	Cope	1
19	Sobe me vatra gaz /korent	Cope	1
20	Trung mishi	Cope	1
21	Tavolina pune inox	Cope	1

### **MENAXHIMI I SHËRBIMIT NGA AUTORITETI KONTRAKTOR**

1. Autoriteti Kontraktor do te kontrolloje e do ti kërkojë operatorit ekonomik respektimin e orarit te gatimit dhe shpërndarjes se ushqimit, zbatimin e normave te racioneve te ushqimit, si dhe pastërtinë ne ambientet gatimit te ushqimit dhe te shpërndarjes se ushqimit.
2. Autoriteti Kontraktor, duhet te mos lejoje operatorin ekonomik qe te përdorë pajisje për gatim dhe inventarë te imët për shpërndarjen e ushqimit jashtë specifikimeve te kërkuara ne dokumentet standarde te tenderit.

*Përlllogaritja për shërbimin e gatim-shpërndarjes së ushqimit realizohet nëpërmjet përcaktimit të çmimit të shërbimit sipas vlefës së racionit ditor. (Racioni ditor është sipas normave përkatëse të përcaktuar në studimin e dërguar nga Ministria e Shëndetësisë me shkresën Nr 142/1 datë 27.08.1997,).*

**Sipas dietave kostot paraqiten si më poshtë:**

#### **Dieta per te rritur     Dieta Nr.1 (Dieta normale)**

2 700 k kal (prot 100Kg, lipide77Kg, glucide420)

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>Sasia</b>
1	Qumesht	L	0.3
2	Sheqer	Kg	0.015
3	Buke	Kg	0.25
4	Oriz,makarona	Kg	0.15
5	Zarzavate	Kg	0.5
6	Vaj	L	0.03
7	Mish	Kg	0.15
8	Fruta	Kg	0.3
9	Djathe,gjize	Kg	0.08
10	Gjalpe	Kg	0.01

Perdoret :Per te semuret me aparat tretes normal.

**Dieta Nr.7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)**

2 000 k kal ( prot.82Kg. Iip.16Kg. gluc.265 Kg.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	L	1.5
2	Sheqer	Kg	0.02
3	Buke	Kg	0.06
4	Oriz	Kg	0.1
5	Gjalpe	Kg	0.02
6	Veze	koker	1
7	Patate	Kg	0.25
8	Djath i njome	Kg	0.07

Perdoret ne disa forma te dispepsive, ne gastritet, gastroduodenitet, ne klecistopatite pas interventeve kirurgjikale ne stomak, abdomen, koleciste, hemihiatale.

**Dieta Nr.12 (Dieta diabetike)**

Dieta me diabetiket me diabet te ekuilibruar.(2 300 k kal (prot.88Kg. lip.92Kg. gluc.278Kg.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	L	0.6
2	Buke	Kg	0.15
3	Zarzavate	Kg	0.5
4	Veze	koker	1
5	Djathe	Kg	0.05
6	Gjalpe	Kg	0.02
7	Oris	Kg	0.1
8	Mish	Kg	0.1
9	Vaj	L	0.025
10	Fruta	Kg	0.5

**Dieta Nr.13 (Dieta normakalorike-shume e varfer ne Na)**

2 200 k kal (prot.90Kg. lip.64Kg. gluc.336Kg.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
----	-------------	------	-------

1	Qumesht/kos	L	0.2
2	Mish	Kg	0.1
3	Veze	kokerr	1
4	Gjize	Kg	0.05
5	Vaj	L	0.03
6	Gjalpe	Kg	0.01
7	Zarzavate	Kg	0.4
8	Fruta	Kg	0.35
9	Buke pa kripe	Kg	0.16
10	Oriz	Kg	0.13

Perdoret ne semundjet ap.kardiovaskulare dhe urinare ne fazen e kompensimit ne semundjen melcise, pankreasit e surenaleve.Perdorimi i kripes nuk duhet bere i lire kur

nisin shenjat dekompozimit.Kur azotemia e kratinemia kur produktet si mishi, qumeshti dhe nderpiten, ne diete shtohen frutat deri ne 1500 Kg.

### **Dieta Nr.14 (Onkologe)**

### **Hiperkalorike,hiperproteinike,hiperglucidike e pasur me Ca e Fe**

3 000 k kal (prot,122Kg. yndymal08Kg. gluc.385Kg.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	L	0.6
2	Mish	Kg	0.2
3	Vaj	L	0.03
4	Gjalpe	Kg	0.015
5	Djadhe/gjize	Kg	0.1
6	Veze	koker	1
7	Sheqer	Kg	0.03
8	Oris	Kg	0.11
9	Zarzavate	Kg	0.5
10	Fruta	Kg	0.4
11	Buke	Kg	0.3

### **Kjo diete rekomandohet edhe per mjekun e rojes**

Kjo diete perdoret ne anemi, kaheksi, TBC, semundje malinje, otopedi, plastike, reabilitim, semundje psiqike.

**Dieta Nr.1 - Diete normale per te gjitha semundjet e ndare me 4 Kgup-mosha**

**1.B. Per femijet 4-6 muaj (500kcal,prot 13.5 Kg,lyra 22.5 Kg,gluk 56.25 Kg)**

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht (formule satandarte 1)	L	0.75
2	Oriz (miell)	Kg	0.005
3	Sheqer	Kg	0.01
4	Perime (te stines)	Kg	0.15

**Dieta Nr.3A per semundje virale, hepatite, tifo, per Kgup moshen 1-3 vjec**

1150 k.kal (prot.38.5Kg, yndyr.50.2Kg, gluk. 152Kg.

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	L	0.33
2	Oriz	Kg	0.02
3	Perime (te stines)	Kg	0.43
4	Djathe (lope, i bardhe)	Kg	0.02
5	Recel	Kg	0.02
6	Vaj (ulliri)	L	0.01
7	Sheqer	Kg	0.035
8	Buke (Kguri)	Kg	0.06
9	Fruta (te stines)	Kg	0.15

**Dieta Nr.3.B. per femije 3-14 vjec, 1800 k.kal (prot.66Kg, yndyr.66Kg, gluk.250Kg.**

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	L	0.5
2	Perime (te stines)	Kg	0.2
3	Vaj (ulliri)	L	0.035
4	Mish (i fresket, vici)	Kg	0.1

AGJENCIA SHITËTËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

5	Fruta (te stines)	Kg	0.35
6	Djathe (lope, i bardhe)	Kg	0.03
7	Sheqer	Kg	0.04
8	Buke	Kg	0.12
9	Oriz	Kg	0.05

- Perllogaritja e fondit limit eshte bere duke marrë cmimin mesatar nga tre Oferta Ekonomike sipas çmimeve te Tregut.
- Numri i dietave eshte bazuar ne vleresimin sipas semundshmerise vjetore te vitit 2022, Shefave te Pavioneve (Urgjence,Pathologji,Pediatrie dheMaternitet ) dhe sipas Statistikes , i cili ka bere nje perllogaritje me numrin e shtreterve qe eshte 22 dhe sherbimin e Mjekut te Rojes ne Urgjence. Gjithashtu vlen te theksohet fakti se keto sasi jane parashikime qe mund te ndryshojne ne varesi te situatave te ndryshme.
- Per mjekun e rojes rekomandimi eshte te perdoret dieta onkologjike per faktin e thjeshte qe profesioni dhe ngarkesa ne pune imponojne nje diete hiperkalorike (ne rastin e dietes 14 eshte 3000 kcal)

Per specifikimet teknike dhe termat e references komisioni u mbeshtet tek rekomandimi i perbashket i agjensise se prokurimit publik me autoritetin kombetar te ushqimit me nr .10181 prot. date 19.11.2018 si me poshte vijon:

### **Specifikimet e artikujve ushqimore qe do te perdoren per zbatimin e dietave ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Kurbin.**

#### **Buke gruri :**

- Te jete e pjekur mire ne masen 1 kg pa ere myku ,thartire dhe hidherimi dhe ere e shije tjeter te huaj.
- Duhet të jetë me rreze 75% e gatuar brenda ditës dhe me miell të papërzier Cilesia te jete sipas standartit shteteror Shqiptar.
- Buka duhet të jetë e prerë në feta dhe e ambalazhuar në qese prej letre dhe te dergohet per konsum jo me pare se 3 ore nga koha e pjekjes dhe te jete e shoqeruar me raport analize nga A.K.U
- Transporti I bukes te behet me mjete te pastra te mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportimin e produkteve ushqimore .

#### **Makarona:**

- Makaronat te jene cilesore ,te etiketuara sipas standartit shteteror.

AGJENCIA SHTETËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

- Makaronat te jene me ere te mire pa shije te hidhur ,te tharte,te mykur dhe cfaredo ere dhe shije tjeter te huaj.
- Te jene te ambalazhuar ne qese celefoni me masen 500 gr dhe te futura ne kuti kartoni .
- Ne ambalazhimin 500 gr te jene te shenuar dhe afati I skadences mbi nje vit nga data e furnizimit.

**Orizi :**

- Te jete me kokrra te pasterta ,te zhveshura teresisht nga levozhga e orizit ,pa shije ,pa shenja myku ose prishje .
- Treguesit teknik te jene sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Te jete I ambalazhuar ne pako 1 kg ku te jete shenuar afati I skadences mbi nje vit nga data e furnizimit.

**Sheqer:**

- Pluhuri te jete I perbere nga kristale te imet dhe te njellojte pa lende te huaja.
- Treguesit teknik sipas Standarteve Shteteror Shqiptar.

- Ambalazhimi : te jete me pako prej letre 1 kg neto ku te jete shenuar edhe afati I skadences mbi 1 vit nga data e furnizimit.

**Vaj :**

- Te jete leng vajor , me ngjyre te verdhe me shije te mire karakteristike e vajit te lulediellit te rafinuar,pa shije dhe ere te huaj.
- Treguesit kimik sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Ambalazhimi do te jete ne shishe plastike me vellim 1 litershe.te mbyllur me tape plastike me vidhezim hermetike te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese.
- Mbi cdoshishe do te vendoset etiketa ne te cilen do te shenohet :
  - Emertimi I plote I mallit
  - Data e skadimit ose afati I perdorimit qe do te jete mbi nje vit nga data e furnizimit .

**Vaj ulliri:**

- Te jete leng vajor me ngjyre ulliri ,pa shije dhe ere te huaj.
- Treguesit kimik sipas standartit shteteror shqiptar .
- Ambalazhimi do te behet ne shishe plastike ose qelqi me vellim 0.5 ose 1 lit ,te mbyllur me tape plastike me vidhezim hermetike te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese.
- Mbi cdo shishe do te vendoset etiketa nete cilen te shenohet .
- Emertimi I plote I mallit.
- Data e skadimit ose afati I perdorimit qe do te jete mbi nje vit nga data e furnizimit .

**Miell gruri:**

- Te jete pluhur I njetrajtshem pa lende te huaja insekte dhe demtues te tjere.

- Ngjyra e bardhe me ere te kendshme karakteristike e miellit te grurit pa ere dhe shije te huaj.
- Treguesit kimik te jene sipas Standarti Shteteror Shqiptar.
- Ambalazhimi te jete ne pako letre 1 kg me etikete prodhuesi dhe afat skadence mni nje vit nga data e furnizimit .
- Rekomandime per perdorim, nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimor keto te dhena te jepen nbi ambalazh dhe etikete.
- Rekomandime per perdorim ,nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimor keto te dhena te jepen nbi.

### **Miell orizi:**

Ngjyra: E bardhe me nuance ngjyre te verdhe Era dhe shija: Karakteristike e miellit te orizit, pa shije te tharet e te hidhur, pa ere te mykur dhe ere tjeter te huaj. Treguesit fiziko- kimike: Lageshtia: 12.8% Aciditeti 0.081% Lende te huaja jo me shume se 0.2% Lende minerale nuk lejohen. Ambalazhimi i paketuar ne qese letre me peshe 0.5kg.-1kg. Marketimi: Emertimi i prodhuesit Emertimi i produktit. Pesha neto Data e skadimit Kushtet e vecanta te ruajtjes Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

### **Recel ose prevede:**

- Te mos jete FIKU, te jete cilesor me ngjyre dhe shije karakteristike.
- I etiketuar sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Te jete e ambalazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht me vellim 25-30gr .
- Te jete me date skadence mbi nje vit nga dita e furnizimit .
- te jete e shoqeruia me flete analize nga AKU dhe ne etikete te jete shenuar edhe emri I prodhuesit .

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE PER PRODUKTIN “ MISH “**

Kërkojmë që mishi me të cilin do të perdoret per dietat qe do te zbatohen ne Spitalin Rajonal Shkoder:

### **Mishi vici :**

#### **Specifikimet teknike.**

Kërkohet mish viçi në rritje me cilësi që të plotësojë kërkesat e standardit shtetëror Nr 1441, te vitit 1987.

### **Pamja e jashtme :**

- Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje.
- Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jetë i tejdukshëm.
- Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta.

**Ngjyra:** Mishi të jetë me ngjyrë rozë dhe i dhjamt të jetë me ngjyrë të bardhë.

**Konsistenca:** Të jetë e butë dhe elastike. Në prerje të duket kompakt.

**Era:** Të jetë e këndshme, karakteristike e llojit.

**a).Pjesa e karkases (shpatull, kofshe, dhe gjoks) duhet te jete e vulosur me vulen e kontrollit vetrinare .**

**b). Cdo parti /karkase duhet te shoqerohet me certifikat vetrinare,e cila garanton sigurin e produktit “mish” dhe me te cilen vertetohet se ,nga kontrolli i kryer nuk eshte prekur nga semundje,por qe eshte i sigurt dhe se lejohet te tregtohet per konsum publik.**

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË BULMETIT**

Kërkojmë që qumështi dhe nënproduktet e tij te cilet do te jene perberes per dietat qe do te zbatohen ne **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin** jane:

#### **DJATHI LOPE I BARDHË :**

- Të jetë i cilësisë I me këto karakteristika :
- Të ketë pamje homogjene ,formë të mirë dhe pa deformime , i fortë ,me erë dhe shije të këndshme.
- Lënda e thatë të jetë jo më pak se 48 % , yndyra në lëndën e thatë të jetë 50% yndyra e përgjithshme të jetë 26 % ,kripa 5%.
- Të mos ketë mikroorganizma dhe djathi të jetë i konsumueshëm pas 60 ditësh nga dita e prodhimit .Lagështia të jete 15 %.
- Te jete i shoqeruar me flete analize nga AKU.
- Amballazhimi te behet ne voza plastike me vellim 5-30lit. Djathi ne voze qendron i mbuluar me shelliren fillestare.
- Mbi cdo ambalazh ne djath vendoset etiketa ne te cilen shenohen emri i prodhuesit ,emri i produktit ,pesha neto ose vellimi i produktit si dhe data e prodhimit .
- Transporti te behet me mjete te mbuluara dhe te destinuara per transport bulmeti.

**DJATH PA KRIP:** Të jetë i cilësisë I

#### **DJATH I NJOMË**

#### **GJALPI :**

- Te jete gjalp baxho,me shije te mire, pa lende te huaja ne perberje ,i fresket cilesor sipas standarteve shteterore.
- Te jete i shoqeruar me flete analizen nga AKU dhe te jete i shoqeruar me etiketen e firmes prodhuese ne ambalazh dhe afatet kohore te perdorimit si dhe data e skadences te perkoje me skadencen ne fleten e analizes se AKU.
- Gjalpi të ketë ngjyrë kremi në të verdhë me 81 % .
- yndyrë ,17 % lagështi dhe 2 % lëndë e thatë .
- Transporti te behet me mjete te mbuluara dhe te destinuara per transport bulmeti.



### **QUMËSHTI :**

- Të jetë qumësht lope e cilësisë së parë me 1.5% -2 % yndyre.
- Qumështi që do të vijë në Spital të jetë prodhim i asaj dite dhe të ketë ngjyrë të bardhë ,erë të këndëshme ,pak i ëmbël pa shije te hidhur dhe djegese te percaktuar ne standartet shteterore .
- Amballazhimi te jete ne shishe plastike me vellim 1 lit-1.5 lit I mbyllur me kapak hermetik shoqeruar me flete analizen leshuar nga AKU dhe afatin e perdorimit.
- Transporti te behet me mjete te specializuara te shitesit ne oret e para te mengjesit.

### **QUMËSHT PER FEMIJË:**

Qumesht formule standarte 1

### **KREM QUMSHTI (PANA)**

#### **BISKOTA :**

- Te jene cilesore ,me shije te mire ,pa shenja myku ose prishje .
- Treguesit kimik sipas standartit shteteror shqiptar.
- Amballazhimi do te jete ne qese telefoni 125-150 gr ku te jene te shenuar data e skadences mbi nje vit nga data e furnizimit.

### **KOS:**

- Te jete i zene me qumesht qe permbush karakteristikat e mesiperme.
- Te jete i ambalazhuar ne gota plastike 200gr.ne te cilet te tregohet firma prodhuese dhe afati i skadences

### **GJIZE :**

- Te jete cilesor ,pa kripe ,pa njolla lende te huaj,te mos jete e hidhur dhe me shije te kendshme Brenda kushteve teknike.
- Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU dhe te kete etiketen e firmes prodhuese ne amballazh.
- Afati I skadences ne etikete te perkoje me daten e skadences ne fleten e analizes nga AKU
- Transporti te behet me mjete te mbuluara te destinuar per transport bulmeti.

### **PERIMET DHE ZARZAVATET E TJERA**

Te jene te cilesise se pare, te fresketa, sipas stines te ambalazhuar ne menyre qe te mos demtohen gjate transportit.

### **VEZET :**

AGJENCIA SHITËTËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

- Te jene pule ,prodhim vendi.
- Kokrra e vezes te jete e fresket ,te kete emrin e prodhuesit dhe te jete shoqeruar me analizen e proves nga AKU .
- Te kete shenuar mbi levozhge kodin qe duhet te perkoje me kodin e vendosur ne fleten e analizes se AKU.

### **PATATE.**

Kërkohet cilësia e parë, të jetë e plotë, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.

Kokrra të jetë e pjekur.

Madhësia e kokrrës për të rrumbullakëtat të jetë për pataten dimërore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm, për vezaket për dimëroret dhe veroret 4 cm.

Nuk lejohen të çara e të prera, të kalbura, njolla boje hiri e ndryshku, dëmtime nga dosa dhe të pa pastruara nga dherat.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1729-88.

Duhet të jenë të ambalazuara në thasë rrjete 25 deri ne 30 kg.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

### **FRUTAT**

- Te jene te fresketa cilesia e pare, sipas stines.

### **LENG FRUTASH ,CAJ,**

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

- Operatori i kontraktuar, ne baze te kontrates, pergatit ushqimin ne menyre te perqendruar ne nje kuzhine per te gjithë pacientet e shtruar ne Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbini, bazuar ne percaktimin dietik te karteles se pacientit si dhe te verifikimit te forces ditore nga Sektori Teknik Mbeshtetes (Hoteleria).
- Ambjenti i kuzhinës ku duhet të realizohet shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit ( Katering) do jetë në ambjentet ne Pronesi / ose ne ambiente te marra me qera te Operatorit Ekonomik qe do te jete fitues ne perfundim te Procedurave te Prokurimit dhe lidhjes se Kontrates.  
Ambjentet duhet të plotësojne të gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas akteve nënligjore në fuqi.  
Gjithashtu përgatit racionet e ushqimit për personelin mjekësor që ndodhet në shërbim 24 orësh mbi 24 ore.
- Operatori i kontraktuar e transporton ushqimin e përgatitur nga kuzhina deri ne Ambientet e Spitalit (minikuzhine), per te gjithë te semuret dhe personelin ne sherbim, me mjetet, pajisjet dhe enet e veta si dhe po me mjetet e veta.

- Sherbimi i shperndarjes se ushqimit deri tek shtrati i pacientit do te realizohet nga punonjes te Institucionit tone.
- Sektori Teknik Mbeshtetes (Hoteleria) ne Spital, ka caktuar nje dhome te vecante (minikuzhine) qe perdoret per mbajtjen e inventarit dhe per shperndarjen e ushqimit.
- Operatori i kontraktuar pergatit racionet e ushqimit sipas nevojave kalorike te dietave ne pasqyrat bashkelidhur, te numrit te te semureve te shtruar, si dhe te personelit mjekesor qe eshte ne sherbim 24 ore mbi 24 ore.
- Numri i te semureve del nga fletet e forces ditore qe plotesohen sipas kartelave nga Kryeinfermieret dhe shefat e sherbimeve te pavioneve dhe dorezohen ne Sektori Teknik Mbeshtetes cdo dite,brenda ores 12.00.
- Sektori Teknik Mbeshtetes (Hoteleria)harton pasqyren permbledhese bazuar ne fletet e forces ditore duke shtuar edhe numrin e personelit mjekesor ne sherbim 24 ore mbi 24 ore. Kete pasqyre ia dorezon pergjegjesit te kuzhines te operatorit te kontraktuar cdo dite, brenda ores 13.00, per dite n e neserme.
- Sektori Teknik Mbeshtetes (Hoteleria) , bazuar ne fletet e forces ditore, ne fillim te cdo muaji, harton pasqyren permbledhese me numrin e te semureve dhe personelit mjekesor sipas dietave per muajin paraardhes. Kjo pasqyre, pasi rakordohet, firmoset nga perfaqesuesit e te dy paleve dhe sherben si baze per kryerjen e pageses cdo muaj nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin per operatorin e kontraktuar.
- Operatori i kontraktuar dorezon Ushqimin tek Sektori Teknik Mbeshtetes(Hoteleria) dhe shperndahet nga Punonjesit tone e servire ushqimin ne pavionet e sherbimit te kirurgjise, te sherbimit te patologjise, te sherbimit te maternitetit sipas dietave, si edhe ne sherbimin e pediatrie.
- Operatori kontraktuar pergatit ushqimin sipas menuse te miratuar nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin, e ndan ne racione 3 here ne dite . Shperndarja behet nga punonjesit e Sektorit Teknik Mbeshtetes(Hoteleria) ne pavione 3 here ne dite: ne mengjes ne oren 7.00-8.00, ne dreke ne oren 11.30-12.30 dhe ne darke,ne oren 18.00-19.00. Ndersa per sherbimin e Pediatrie, e shperndan 5 here ne dite, pervec vakteve te sipercituara edhe ne mengjes ne oren 10:00-10:30 dhe mbasdite ne vaktin “zamer” 15:00-15:30 sipas dietave.
- Operatori i kontraktuar zbaton kerkesat e ligjit nr. 9663 date 28.01.2008 « Per ushqimin », per furnizimin me artikujt ushqimore ne brendesi te kuzhines si dhe per ruajtjen e higjenes te mjedisit dhe personelit.
- Inventari i imet (pjata, luge, pirunj, tabaka etj.) jane prone e sipermarresit te cilet i dorezohen nga Punonjesit e shperndarjes sipas inventarit perkates.
- Operatori i kontraktuar pergatit ushqimin per personelin mjekesor qe eshte ne sherbim 24 ore mbi 24 ore, ne vendet qe do te caktohen nga Spitali per kete qellim.
- Furnizimi me energji elektrike dhe uje kryhet ne baze te kontratave te lidhura nga operatori i kontraktuar me ndermarrjen furnizuese perkatese.
- Operatori i kontraktuar kryen gjithashtu edhe larjen dhe dizinfektimin e inventareve te imta dhe paisjeve qe perdoren brenda pavionit.
- OE duhet te zbatoje kerkesat e ligjit Nr.9863 date 28.01.2008 “për Ushqimin “I ndryshuar, për furnizimin /shpërndarjen me produktet ushqimore ne ambientet e

- përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit ,kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
- Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet te jene ne përputhje dhe ne respektim te standardeve te kërkuara në aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi konform manualit te vetëkontrollit HACCP.
  - Transporti I ushqimit te përgatitur nga kuzhina e shërbimit te ushqimit social për grupet e veçanta deri te pacienti, te realizohet me mjete,pajisje dhe ene te posaçme (termuse )te llojeve dhe madhësive te ndryshme ne funksion te sasisë qe ofrohet si dhe për te ruajtur nivelin kulinar te ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit te produktit ).
  - Produktet ushqimore (lënda e pare) qe do te përpunohen, trajnohen apo ambalazhohen ne ambientet e përpunimit ( kuzhinës )qe disponon sipërmarrësi te jene te shoqëruara me flete analize përkatës.
  - Operatori ekonomik te respektojë rregullat e higjienës për larjen ,pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve,frutave sipas kërkesave te ligjeve ne fuqi ne fushën e higjienës dhe ushqimit.
  - Operatori për qëllime higjiene dhe pastrimi te përdorë detergjent dhe solucione kimike te certifikuara nga institucione e njohura me ligj dhe te padëmshme për shëndetin e njerëzve te përcaktuara sipas akteve ne fuqi (Urdhër Nr.365 dt.03.08.2012 I MSH “ për miratimin e listës dhe përdorimin e lendeve qe përdoren për dezinfektim, deratizimit, dezinfektim ne shëndetin publik).
  - Operatori ekonomik duhet te sigurojë një higjiene te përditshme ne mbajtjen e pajisjeve te kuzhinës, ambienteve te gatimit ,atyre te ndarjes se ushqimit dhe mensave.
  - Operatori ekonomik duhet te realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve qe përdoren.
  - Pastrimi I inventarit te imët kryhet nga operatori ekonomik I cili duhet te mbaje edhe regjistrat e pastrimit.
  - Ne rast te sëmundjeve infektive te përdoren për shpërndarjen te ushqimit vetëm pajisje te veçanta dhe njëpërdorimshme.
  - Operatori ekonomik do te paketojë dhe te evadojë çdo dite mbeturinat qe krijohen si rezultat I prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit te ushqimit ne vendet e caktuara si vend grumbullimi mbeturinash.
  - Materiali ne kontakt me ushqimin (termuset, enët, etj )me te cilat transportohet ushqimi ) te jene material I përshtatshëm dhe lehtësisht te pastrueshme, sipas kërkesave te Udhëzimit te Ministrit te Bujqësisë Nr.22 date 25.11.2010 “Kushtet e përgjithshme dhe te veçanta te higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor” me mbyllje hermetike ( për te siguruar mbrojtjen nga mjedisi I jashtëm) Enët qe përdoren për transportin dhe/ose shpërndarjen e ushqimit duhet te jene me material jo te dëmshëm për shëndetin .
  - Punonjësit e operatorit ekonomik ne momentin e përgatitjes/shërbimit te ushqimit ne ambientet perkatese, duhet te jene pajisur me uniformen, veshjen perkatese te punes (perparese, grykese, kepuce, pantallona )keta te fundit te jene te pajisur me librezë shendetesore .

Shërbimeve

AGJENCIA SHTETËRORE E PROKURIMEVE PËRQENDRUARA

- Operatori ekonomik duhet qe ne cdo kohe te shoqeroje ushqimin e gatuar me dokumentacionin perkates deri ne konsumimin e plote te tij dhe te garantoje sigurine e produktit nepermjet gjurmueshmerise se tij sipas VKM Nr.760 date 16.09.2015 “ Per kerkesat per gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit per kafshe pergjate zinxhirit ushqimor”dhe analizat e ujit qe perdor .
  
- Operatori ekonomik eshte i detyruar te ruaje ne rafte te vecanta ne mjedisin e kuzhines, kampionet e ushqimit te gatuar e qe shperndahet per ngrenie per te gjitha vaktet. Afati i ruajtjes se mostrave ( kampioneve ) eshte 24-ore. Kur ka denoncime per cilesine e ushqimit ky afat zgjat deri ne zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.
- Operatori ekonomik do te mbuloje shpenzimet ekonomike te nevojshme per realizimin e analizave laboratorike te mostrave te ushqimit gatuar, sa here qe kerkohet nga autoriteti kontraktor .

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

1	2		3
NR.	Përshkrimi i shërbimi	Njësia	Sasia e pritshme
1	<b>Dieta nr 1</b> (Dieta normale 2700 kkl, per te rritur )	rd	634
2	<b>Dieta nr 7</b> (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute) 2 000 k kal ( prot.82Kg. Iip.16Kg. gluc.265 Kg.)	rd	489
3	<b>Dieta nr 12</b> (Dieta diabetike) Dieta me diabetiket me diabet te ejkulibruar.(2 300 k kal (prot.88Kg. lip.92Kg. gluc.278Kg.)	rd	612
4	<b>Dieta nr.13</b> (Dieta normakalorike-shume e varfer ne Na) 2 200 k kal (prot.90Kg. lip.64Kg. gluc.336Kg.)	rd	554
5	<b>Dieta Nr.1B</b> normale 4-6 muaj (500kcal,prot 13.5 Kg,lyra 22.5 Kg,gluk 56.25 Kg)	rd	406
6	<b>Dieta Nr.3 A</b> (per semundje virale,hepatite,tifo,per Kgup moshen 1-3 vjeç )	rd	279
7	<b>Dieta Nr.3 B</b> (per femije moshen 3-14 vjeç, 1800 k.kal )	rd	349
8	<b>Mjekun I Rojes</b> (sipas dietes nr 14 onkologjike)	rd	702

Afatet e ekzekutimit te shërbimit 2 vite nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** Furnizimi **“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering) për Spitalin e Ri të DSHS-Kurbin“**-Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj , per nje periudhe prej 24 muaj, sipas programit ushqimor të përgatitur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Në ambientet e autoritetit kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin.

#### ***Kerkesa të përgjithshme:***

- Te siguroje furnizimin ne kohe dhe me cilësinë e kërkuar te ushqimit te gatuar.
- Te garantoje ne çdo kohe shumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas dietave të përcaktuara për pacientët.
- Te siguroje ushqim te sigurve për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet qe mund te shkaktohen nga ushqimi.
- Të bëjë kompletimin e ambienteve me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen dhe gatimin e ushqimit.
- Te siguroje kushtet e nevojshme higjeno sanitare për realizimin e shërbimit.
- Te siguroje shërbim me standarde te larta.

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.



Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nën ligjore.

#### **Shënim 1.1:**

